

## INTERVISTA



**DEFRIM FIKU:  
30 QERSHORI NË  
BULQIZË ISHTE NJË  
MASKARADË**

Faqe 6-7

## STUDIMI



**POZITA GJEOGRAFIKE  
DHE RESURSET  
TURISTIKE TË  
BASHKISË BULQIZË**

Faqe 8-9

## PËRKUJTIMORE



**NJË VIT PA  
ELMIR ISAKUN !**

JETA E TIJ U NDËRPRE NË MES NË  
NJË MOSHË TË RE, KUR FAMILJA  
DHE SHOQËRIA KISHTE MË SHUMË  
NEVOJË PËR TË

Faqe 5

*Kryetari i PD në Bulqizë: Kriza më e rëndë që kërcënon vendin është uzurpimi i institucioneve dhe thellimi i varfërisë së shqiparëve*

# BASHA: BULQIZA ËSHTË SUPER E PASUR POR E VJEDHUR



**Babëzia e vjedhjes  
dhe egërsia për  
pushtet**

Në rrethin e Bulqizës ka ndodhur ajo që ka ndodhur në gjithë Shqipërinë, fenomeni i fletëve të votimit është më i madh se ai i raportuar. Babëzia e vjedhjes dhe egërsia për pushtet ka bërë që komisionerët që kanë futur fletëvotimi në kutitë e votimit nuk kanë mundur t'i rakordojnë manipulimet e kryera duke krijuar një kakofoni shifrash me diferencë të konsiderueshme nga votimi në fakt dhe sipas raportimeve të institucioneve zgjedhore. Natyrisht, kjo është një situatë që i vjen në ndihmë opinionit dhe fakteve që Partia Demokratike ka interpretuar dhe po interpreton çdo ditë, se si është abuzuar me votimet dhe zgjedhjet në Shqipëri, të paktën që nga viti 2015.

Faqe 7

**KRYETARI I PD-SË, BASHA U SHPREH NGA  
BULQIZA SE ZGJIDHJA E VETME E KRIZËS  
ËSHTË ZHVILLIMI I ZGJEDHJEVE TË PARA-  
KOHËSHME PARLAMENTARE DHE LOKALE**

Faqe 3

## SPORTI

**Boks, uragani Ferit Keta shkatërron  
serbin që në raundin e tretë**



Ferit Keta vazhdon të shkëlqejë në boks profesionist, duke regjistruar vetëm fitore. Në mesnatën e së shtunës duke u gdhirë e diela, 30-vjeçari shqiptar korri suksesin e tij të 13-të në karrierë duke shkatërruar serbin Slavoljub Mitij, në duelin e zhvilluar në Maltë, për peshat "kruizer" më 28 korrik.

Faqe 12

## TAKIMI

Faqe 2

**Demokratët e Dibrës,  
leksion trimërie dhe  
qytetarie**

BASHA FALENDERON DIBRANËT PËR  
MBËSHTETJEN NË PROTESTAT KOMBËTARE

## REAGIMI

Faqe 2

**Uzurpoi zyrat i braktisur  
masivisht nga matjanët**

## DHURATA ÇUPI

## DEKLARATA

Faqe 2

**Ndryshimi do të vijë  
vetëm përmes largimit  
të Edi Ramës**

## HOMAZHE

Faqe 4

**LAMTUMIRË  
LUAN PUSTINA**

## PROTESTA

Faqe 4

**Banorët e Zërqanit  
kundërshtojnë projektin e  
ujësjellësit të fshatit Peladhi**

## AKTUALITET

Faqe 4

**BULQIZË, BANORËT TË  
RREZIKUAR KUR HYJNË NË  
BANESA**



# Demokratët e Dibrës, leksion trimërie dhe qytetarie

**“QË TË PËRPAROJË EKONOMIA DUHET TË MARRË FUND HAJDUTËRIA ME PASURITË E SHQIPTARËVE, ME BUXHETIN ME PASURITË MINERARE”,- tha Basha në takimin që u zhvilluan në qytetin e Peshkopisë ku u prit me mjaft pjesëmarrje dhe interes nga demokratët dhe qytetarët dibranë**



Në situatën e krijuar pas votimeve të padekretuara të 20 qershorit, Kryetari i Partisë Demokratike zoti Lulzim Basha ka vijuar takimet e tij me qytetarët në qarkun e Dibrës. Basha u zhvendos pasditën e së martës, më 23 korrik 2019, në qytetin e Peshkopisë. I ardhur nga Kukësi, fillimisht Basha u ndal në njësinë administrative Kastriot, pasi një grup mbështetësish i dolën përpara për ta takuar. Më pas takimet e tij u zhvilluan në qytetin e Peshkopisë ku u prit me mjaft pjesëmarrje dhe interes nga demokratët dibranë. Nga ky qytet, Basha u shpreh se në vend të të burgosurve politikë, që nga 16 Shkurti, duhet të ishin vjedhësit e zg-

jedhjeve të 2016 në Bashkinë Dibrë.

“Demokratët e Dibrës kanë dhënë një leksion kurajoje, trimërie dhe qytetarie prej 16 shkurtit e në vijim. Në çdo protestë pjesëmarrja e dibranëve ka qenë e fuqishme dhe ato erdhën duke u bërë gjithmonë edhe më të mëdha, gjithmonë edhe më të fuqishme.


Demokratët dibranë dhe qytetarët e Dibrës kanë spikatur me pjesëmarrje, kanë spikatur me vendosmëri, kanë spikatur me kurajo. Kjo nuk i ka shpëtuar askujt, të gjithë e dinë, të gjithë e kanë vënë re dëshirën e përpambajtshme për të protestuar për padrejtësitë që i janë bërë komunitetit dibran. Duke qenë balli i betejës që

ju keni zënë si Dibrë dhe si dibranë nuk ka shpëtuar nga vëmendja as e regjimit kriminal.

Ky regjim riktheu të burgosurit politik me afro 160 të burgosur politikë prej 16 shkurtit, mori dhe futi në mënyrë të paligjshme në qelitë e burgjeve protestues ndaj tij, aty ku duhet të ishin ata që u kapën duke vjedhur votën me zë dhe figure. Por në vend të tyre çuan në burgje qytetarët që protestonin kundër krimit të tyre. Pas 30 qershorit ne bëmë protestën më të madhe që ka njohur ndonjëherë Shqipëria, jo në një shesh, por në gjithë qytetet dhe fshatrat e Shqipërisë njëkohësisht, me 85% të qytetarëve pjesëmarrës

në referendumin popullor “Rama I”. Referendumi “Rama I” i 30 Qershorit ndodh në kushtet kur Shqipëria është në kolaps total ekonomik për shkak të babazisë dhe hajdutërisë së Edi Ramës dhe një bande njerëzish që janë vërsulur mbi buxhetin e shtetit mbi pasuritë e shqiptarëve që kanë kthyer çdo institucion të shtetit një instrument vjedhjeje duke nisur me parlamentin dhe duke vazhduar me drejtorinë më të fundit në qarkun më të largët të Shqipërisë”, -tha Basha në takimin që u zhvilluan në qytetin e Peshkopisë ku u prit me mjaft pjesëmarrje dhe interes nga demokratët dhe qytetarët dibranë.

## Ndryshimi do të vijë vetëm përmes largimit të Edi Ramës



### XHEMAL GJUNKSHI

Hajdutëria e Edi Ramës është arsyeja për Shqipërinë e papunë dhe në krizë. “Nga mëngjesi deri në darkë plani i Edi Ramës është grabitja, vjedhja. Kjo është arsyeja pse Shqipëria është e papunë. Kjo është arsyeja se pse Shqipëria lëngon në krizën më të thellë ekonomike. Kjo është arsyeja pse shëndetësia, arsimit dhe gjithçka tjetër

janë në kolaps. Kjo është arsyeja pse po përjetojmë emigracionin më gërryes dhe më të rrezikshëm se ai i fillim viteve ‘90” Duke iu referuar 30 qershorit si një referendum popullor për ndryshim, kreu i opozitës u shpreh se ky ndryshim do të vijë vetëm përmes largimit të Edi Ramës, duke i dhënë fund, bashkë me të, edhe bandës së oligarkëve dhe hajdutëve.

## Uzurpoi zyrat i braktisur masivisht nga matjanët

### DHURATA ÇUPI

Personi i emëruar nga Edi Rama në krye të bashkisë, si një shpërblim për nderet e bëra ndaj tij, mori një detyrë jolegjitime. U emërua në krye të Bashkisë nga votimet brenda PS, një person i refuzuar masivisht nga qytetarët të cilët me sa duket e njohin ligjin më mirë se sa vetë ata që e kanë bërë.

Vetë u votuan, vetë i mbushën kutitë vetë i numëruan dhe vetë u shpallën fitues. Sot pas një përpjekje marramendëse për të përshtatur të dhënat sipas urdhërave partiakë, Komisioni Qendror i Vjedhjeve shpall rezultatit: partia voton dhe partia fiton. Monizmi në aksion. Pritet parada e kryerilindasit me 61 rilindasit.

Ne nuk duhet të lejojmë kthimin e diktaturës.

Do të jetë e afërt dita që do të largohet me turp nga ajo zyrë, të cilën sot e uzurpon kryebashkiaku i emëruar i Ramës.

Do të jetë e afërt dita kur nuk do



të mund t’u dalë dot më përpara matjanëve.

Do të jetë e afërt dita kur kësaj marrëzie do t’i vijë fundi.

Shqiptarët duan zgjedhje jo votime partiake....



# Basha: Bulqiza është super e pasur por e vjedhur

**KRYETARI I PD-SË, BASHA U SHPREH NGA BULQIZA SE ZGJIDHJA E VETME E KRIZËS ËSHTË ZHVILLIMI I ZGJEDHJEVE TË PARAKOHËSHME PARLAMENTARE DHE LOKALE**

Pas Peshkopisë, Basha është ndalur në Bulqizë ku zhvilloi takime të ndryshme me qytetarë e drejtues lokal të Partisë Demokratike. Nga Bulqiza kreu demokrat tha se Partia Demokratike ka një program të plotë mbi zhvillimin e vendit duke e kthyer pasurinë publike te populli dhe jo të grabitet nga politikanë dhe oligarkë. Duke u ndalur në situatën e rëndë politike, ekonomike dhe sociale që e ka katandisur vendin qeverisja e Edi Ramës, kreu i opozitës shqiptare, të bashkuar si kurrë ndonjëherë, theksoi se kriza më e rëndë që kërcënon vendin është uzurpimi i institucioneve dhe thellimi i varfërisë së shqiptarëve.

“Në qoftëse sot shqiptarët janë të papunë, janë sepse i ka vjedhur Edi Rama, nëqoftëse sot shqiptarët janë pa lek, janë sepse lekët ua ka marrë Edi Rama me një grup oligarkësh dhe banditë të tij. Shqipëria është e pasur por e vjedhur, por Bulqiza është super e pasur por e vjedhur. Nuk më shqiten nga mendja imazhet e fëmijëve bulqizakë duke u rropatur shpateve në stogjet e kromit për të mbledhur gurët e kromit si shfaqja më mizore, duhet të jetë sigurisht shfaqja më mizore që kemi parë ndonjëherë në Europë.

Është tronditëse për mua, është tronditëse për çdo prind dhe për çdo shqiptar. Ja ku i keni fëmijët, fëmijët duam t'i çojmë nëpër shkolla, në arsim të mire, duhet t'i çojmë në universitete, t'i përgatisim si qytetarë europianë për tregun europian dhe jo të rropaten si skllëvër. Ky krimi-



nalitet duhet të marrë fund një orë e më parë. Papunësia e shqiptarëve e ka një shkakhtar. Ky është Edi Rama me politikën e tij të grabitjes, njeriu që vetëm vjedh mashtron dhe shpërfill shqiptarët. Hajdutëria me buxhetin, hajdutëria me minierat, hajdutëria me pasuritë e shqiptarëve duhet të marrë fund, që të fillojë të

lëvizë ekonomia, që të punësohen bulqizakët dhe gjithë shqipëtarët dhe që të ketë një të ardhme dhe perspektivë për rininë dhe fëmijët në vendin e tyre. Këto janë detyrat tona si demokratë. Unë duhet t'ju falenderoj me mirënjohjen më të thellë për betejën e jashtëzakonshme që kemi zhvilluar së bashku. Ju jam shumë

mirënjohës demokratëve të Bulqizës dhe drejtuesve politikë të Bulqizës. Ju kam parë dhe jemi takuar në çdo protestë dhe e kam mësuar përmendësh vendin ku rreshtohen demokratët dhe qytetarët e Bulqizës dhe ku përshëndetemi”, tha lideri i opozitës shqiptare Lulzim Basha në takimimin me demokratët e Bulqizës.

## Zgjedhjet e parakohëshme parlamentare dhe lokale, domosdoshmëri

Kryetari i PD-së Lulzim Basha u shpreh nga Bulqiza, se zgjidhja e vetme e krizës është zhvillimi i zgjedhjeve të parakohëshme, parlamentare dhe lokale.

“Koha e një klani të ngushtë në shërbim të Edi Ramës ka marrë fund, koha e nipit dhe dajës që marrin të dy bashkë 500 milionë euro koncesione, njëri “Rrugën e Arbrit” tjetri Milot-Balldren, me katërfishin e çmimit ka marrë fund, edhe koha kur nipi me dajën ndajnë bastet njëri me PS e tjetri me partinë tjetër ka marrë fund, ta ndajnë mendjen. Nuk shkohet shumë gjatë me një këmbë këtej një këmbë andej, se populli e ka një thënie të mirë se çfarë ndodh pastaj, “çahesh në mes apo jo?” Opozita është e bashkuar, opozita është e vendosur, 30 qershori i vuri vulën. Deri më 30 qershor bota kishte parë përmes përgjimeve të Bildit se çfarë hajduti është Edi Rama, se si bashkëpunon ai me

krimin e organizuar për pushtetin e tij, por më 30 qershor e kapën gafil. ODHIR, mjeku ligjor i zgjedhjeve e kapi gafil edhe kur kandidonte vetë, votonte vetë, numëronte vetë, certifikonte vetë, tabulonte vetë, prap se prap nuk ndenji pa e vjedhur dot, edhe veten e tij. Ky është treguesi i qartë se me Edi Ramën nuk ka zgjedhje të lira dhe të ndershme, ky është treguesi i qartë se çfarë hajduti psikik ka sot Shqipëria në krye të vendit ndaj detyra jonë është që të mos humbasim asnjë minutë.

Tashmë jemi në një situatë ku 50% e punës është fryma, 50% është organizimi. Tani ka ardhur koha t'i kushtojmë më shumë vëmendje dhe më shumë burime njerëzore për të dytën paharruar të parën. Ka ardhur koha që krahas opozitës së fortë dhe të vendosur me një aksion të qartë politik dhe me objektiva të pandryshuara që kemi bërë deri sot të nisim së

bashku edhe aksionin tonë si alternativë si shumicë e ardhshme qeverisëse e vendit. Këto janë porositi dhe instruksionet që do t'i jap edhe kryesisë edhe shtabit politik të Bulqizës, ndërsa gjithsecilit prej jush dua t'ju shpreh mirënjohjen më të thellë që nuk gjej fjalë për ta shprehur. Çdo bulqizaku, të gjithë demokratëve dhe mbështetasve tanë por edhe socialistëve të ndershëm që e braktisën dhe e refuzuan Edi Ramën me 30 qershor t'i shprehni mirënjohjen dhe t'i siguron në emrin tim, në emër të Partisë demokratike dhe në emër të opozitës, se ndryshimi që po vjen do të jetë ndryshimi i vërtetë dhe pozitiv për gjithsecilin prej tyre, pavarësisht prej bindjeve të tyre. Mirënjohjen më të thellë për gjithçka që keni bërë deri më sot. Tani na duhet të dyfishojmë përpjekjet sepse koha nuk pret, vendi kërkon zgjidhje dhe zgjidhja e vetme janë zgjedhjet e parakohshme parla-

mentare në një ditë me zgjedhjet kushtetuese vendore me kujdestarinë e një qeverie tranzitore pa Edi Ramën dhe një drejtësi të çliaruar që do të dënojë e çojë prapa hekurave ata që vodhën votat e Bulqizakëve, ato që vodhën votën e dibranëve, ato që vodhën votën e shqiptarëve. Këto janë qëndrimet tona, ky është vullneti ynë, ky është vullneti juaj, do t'i shkojmë deri në fund, do t'i shkojmë deri në fitore. Mirënjohje dhe falenderime me bindjen më të thellë që me të njëjtin pasion që kemi qëndruar deri sot, betejën e sotme do ta vazhdojmë deri në fund, këtë betejë për të bërë të mundur që në kutitë e votimit me zgjedhje të lira dhe të ndershme, shumica dërrmuese “Rama I” e 30 qershorit do të kthehet në shumicën e qeverisjes së re, qeverisjes nga njerëzit, të njerëzve dhe për njerëzit”, -deklaroi Basha në takimimin me qytetarë e drejtues lokalë të Partisë Demokratike.



Për kundërshtimin e këtij ujësjellësi banorët i janë drejtuar me peticion Bashkisë Bulqizë dhe prefektit të Qarkut Dibër

protesta

# Banorët e Zerqanit kundërshtojnë projektin e ujësjellësit të fshatit Peladhi

*Një investim i Bashkisë Bulqizë për ndërtimin e ujësjellësit të fshatit Peladhi, ka sjellë përplasje me banorët e fshatit Zerqan, ku ndodhet edhe burimi që do të shfrytëzohet. Banorët e fshatit Zerqan e kundërshtojnë një projekt të tillë që ky ujësjellës të shfrytëzojë burimin që ndodhet në "Zabelin e Madh" pasi ky burim nuk mbulon as nevojat e fshatit.*



jithshëm i Bashkisë Bulqizë, Leonard Daçi refuzoi që të takonte banorët. Kjo ka irrituar banorët që po protestonin jashtë ambienteve të bashkisë, çka solli përplasje me punonjësit e Policisë së Shtetit dhe me policinë bashkiake.

**P**ak ditë më parë 17 banorë të Zerqanit u shoqëruan në Komisariatit të Policisë Bulqizë, pasi janë denoncuar nga firma fituese e tenderit se kanë penguar punimet për ndërtimin e ujësjellësit.

Një investim i Bashkisë Bulqizë për ndërtimin e ujësjellësit të fshatit Peladhi, ka sjellë përplasje me banorët e fshatit Zerqan, ku ndodhet edhe burimi që do të shfrytëzohet. Banorët e fshatit Zerqan e kundërshtojnë një projekt të tillë që ky ujësjellës të

shfrytëzojë burimin që ndodhet në "Zabelin e Madh" pasi ky burim nuk mbulon as nevojat e fshatit.

Banorët shprehen për "Bulqiza ime" se për kundërshtimin e këtij ujësjellësi i janë drejtuar me peticion Bashkisë Bulqizë dhe prefektit të Qarkut Dibër, pasi po ndërtohet pa marrë dakordësinë e banorëve dhe pa marrë parasysh nevojat për ujë të vetë zonës.

Investimi i Bashkisë Bulqizë me vlerë prej 22 milionë lekë (të reja) ka nisur që prej vitit 2017 dhe po zbatohet nga operatori kontraktues EGLAND SHPK dhe BE-IS SHPK, por pa mundur që rrjeti kryesor i ujësjellësit të lidhet me burimin, pasi banorët kanë bllokuar punimet që firma po kryente për hapjen e kanalit.

## NUK LEJUAN HAPJEN E KANALIT TË UJËSJELLËSIT 17 TË SHOQËRUAR NGA POLICIA E BULQIZËS

Nisja e një investimi për ndërtimin e ujësjellësit Peladhi, ka sjellë përplasje mes firmës ndërtuese me banorët e fshatit Zerqan. Banorët nuk kanë lejuar punimet pasi sipas tyre nuk është bërë transparenca mes banorëve dhe bashkisë. Ata e kanë kundërshtuar me forcë këtë projekt i cili ka të bëjë me shfrytëzimin e burimit të ujit që ndodhet në "Zabelin e Madh" në fshatin Zerqan. Për këtë policia e Bulqizës ka shoqëruar 17 banorë të fshatit Zerqan në komisariat, pasi pak ditë më parë banorët nuk lejuan hapjen e kanalit të ujësjellësit për fshatin Peladhi. Një nga të shoqëruarit ishte edhe kryeplaku i fshatit Zerqan Olsi Gurra, i cili tha se u jemi drejtuar disa herë institucioneve me peticion që në vitin 2017 dhe se nga ana e tyre nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Janë cënuar disa lloje ligjesh shprehet kryeplaku i fshatit, pasi burimi i cili ndodhet në Zabelin e Madh është shpallur zonë e mbrojtur që në vitin 2002, si dhe fshati Zerqan, është futur në projektin e 100 fshatrave nga ana e kryeministrit Rama. Sipas banorëve të fshatit Zerqan të cilët janë mbledhur para komisariatit në mbështetje të banorëve të shoqëruar shprehen se marrja e ujit është një grabitje, ata shprehen se për ndërtimin e ujësjellësit bashkia nuk është konsultuar me banorët, Mentor Lala i cili aktualisht është edhe këshilltar pranë bashkisë Bulqizë, shprehet se projektin për marrjen e atij vendburimi nuk është miratuar sa herë që është propozuar

## DRITAN JASHARI, "NDERI I KULTURËS DIBRANE"



**N**ë Pallatin e Kulturës "Haki Stërmilli" të qytetit të Peshkopisë, u zhvillua ceremonia e dekorimit të këngëtarit Dritan Jashari, këngëtar i talentuar popullor, me titullin "Nderi i Kulturës Dibrane", nga Këshilli Bashkiak Dibër,

nën moderimin e gazetarit të njohur Defrim Methasani.

Të pranishëm ishin qytetarë, intelektualë, këngëtarë e këngëtare të njohur, të cilët, përformuan këngë popullore për pjesëmarrësit. Në mesin e tyre ishte edhe z. Leonard Tase,

këshilltar i Presidentit të Republikës për sportin e kulturën dhe z. Flamur Bulku-nënkryetar i Këshillit Bashkiak të Dibrës. Në këtë aktivitet përformuan grupi i valleve të Ansambllit Dibra. Kënduan këngëtarët e njohur Nexhip Dida, Vera Laçi, Artan Kola, Perlat Sheqeri, Mendi Puci dhe Dritan Jashari. Përshëndetën dhe vlerësuan aktivitetin artistik të z. Dritan Jashari: Veli Vraniçi, Baftjar Çera, Fatos Daci, Miçe Duka, Bardhok Rajta, Linda Vraniçi etj. Titulli, i akorduar për z. Dritan Jashari, u dorëzua nga z. Flamur Bulku nënkryetar i këshillit bashkiak. Në mbarim të aktivitetit, të gjithë të pranishmit morën si kujtim fotografi me njëri-tjetrin dhe me Dritanin. Më pas, për të pranishmit u shtrua një dreke bujare nga familja Jashari, ku u kënduan këngë dhe u hodhën valle popullore.



# Një vit pa Elmir Isakun!

Familjarët, të afërmit, miqtë dhe shokët përkujtuan me nderim dhe respekt të veçantë Elmir Isakun, në një vjetorin e ndarjes së tij nga jeta.

Një vit më parë, më 2 gusht 2018 një aksident tragjik, automobilistik, i mori jetën inxhinierit të talentuar që la gjurmë në çdo vend ku ka punuar e jetuar.

Një vit më parë, më 3 gusht 2018, familjarë, të afërm, miq e shokë nga e gjitha Dibra, Bulqiza, Tirana, Burreli, Lezha, Kukësi erdhën për t'i dhënë lamtumirën e fundit, prindit, vëllait, shokut e mikut të tyre të mirë, Elmir Isaku. Një përcjellje dinjitoze nga mijëra vetë, i bënë atij nderimet që meritonte.

Elmir Isaku lindi në vitin 1969 në fshatin Grezhdan të Qarkut Dibër.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje me rezultate të shkëlqyera.

Në vitin 1983 u vendos në Peshkopi në konvikt ku vazhdoi studimet në shkollën e mesme për teknik ndërtimi.

Maturën e mbaroi në vitin 1987 me rezultate të shkëlqyera.

Më pas, po në këtë vit vazhdoi studimet e larta në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, ku në vitin 1993, u diplomua me titullin Inxhinier për Ndërtime Civile dhe Industriale. Më pas Elmiri punoi si inxhinier në sektorin publik në Policinë e Ndërtimit e Shqipërisë, inxhinier në Posta shqiptare dhe së fundmi inxhinier në Prefekturën e Qarkut Dibër. Në sektorin privat



punoi si drejtues teknik në kompani private dhe si sipërmarrës privat. Në të gjithë kohën që ka punuar Elmiri është shquar si një profesionist me aftësi shumë të mira drejtuese. Ai la gjurmë si profesionist i shquar duke punuar në detyrën e drejtuesit teknik te "ISAKU" shpk, dhe "Dema Patin" shpk. Gjatë viteve 1990 si të

gjithë studentët e atij brezi dhe Elmiri mori pjesë në Lëvizjet e Dhjetorit për ndryshimin e sistemit komunist, siç ishte protesta tek Greva e Urisë, Rrëzimi i bustit të Diktatorit deri në themelimin e Partisë Demokratike.

Këto lëvizje formësuan Elmirin si një antikomunist që mbështetej në principe liberal-demokrate,

**• Gjatë viteve 1990 si të gjithë studentët e atij brezi dhe Elmiri mori pjesë në Lëvizjet e Dhjetorit për ndryshimin e sistemit komunist, siç ishte protesta tek Greva e Urisë, Rrëzimi i bustit të Diktatorit deri në themelimin e Partisë Demokratike. Këto lëvizje formësuan Elmirin si një antikomunist që mbështetej në principe liberal-demokrate, bindje këto që e shoqëruan gjatë gjithë jetës dhe mbetën të pandryshueshme**

bindje këto që e shoqëruan gjatë gjithë jetës dhe mbetën të pandryshueshme. Në aspektin njerëzor, Elmiri ishte i veçantë. Kishte karakter të fortë, dhe kishte një shpirt të lirë. Ishte shumë i dashur me shokët dhe familjen. Në çdo tavolinë apo ambient ku ishte i pranishëm kishte vetëm gëzim dhe humor. Tek ai nuk ekzistonte xhelozia apo qejfmbetje.

Në shpirtin e Elmirit ekzistonte Zoti, një tipar që herë pas here e shfaqte dhe e predikonte. Ishte një besimtar i devotshëm. Tek ai gjithmonë do të gjeje dashuri, zemër të hapur, çiltërsi, mirësi, tipare këto të një njeriu me shpirt të madh.

Jeta e tij u ndërpre në mes në një moshë të re, kur familja dhe shoqëria kishte më shumë nevojë për të. Për ne, shokët, është një humbje e madhe dhe do ta kujtojmë gjithmonë të qeshur, një figurë simpatike që të shtonte gëzimin me humorin e tij. Humbje e madhe për familjen dhe vëllezërit që i deshi aq shumë. Ai la në pikëllim të thellë vëllezërit dhe motrat të cilët e mbështetën, e donin dhe e respektonin aq shumë duke ia bërë jetën të këndshme dhe të dashur.

Ishte një vdekje e parakohëshme, e dhimbëshme, tragjike kur mendon se ai ishte në kulmin e lulëzimit të lumturisë familjare.

Një humbje e madhe është për Rajmondën, një intelektuale dhe bashkëshorte shembullore dhe për dy vajzat e vogla që u rritën si engjëj nën kujdesin e tij.

Shpirti yt qoftë në paqe, në parajsë, Elmir! Do të na mungosh...!

**Ing. Gjuri SHEHU  
Ing. Sali SHIRA**

## TURIZMI

### Disa nga resurset turistike të rajonit të Bulqizës

#### LIQENET E DHOKSIT

Liqenet e Dhoksit, bëjnë pjesë në listën e gjetjeve të rreth 430 specieve diatomesh në të gjithë vendin, ku mbi 100 lloje u përkasin Listës së Kuqe Evropiane, dhe disa janë përshkruar si të reja ose paraqesin ende interes.

#### LIQENI I ZI

Liqeni i Zi është monument natyre. Administrrohet nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Liqeni i Zi ndodhet në shpatin verior të malit të Lopës (Martanesh), në lartësinë mbi 1800 m të malësisë së Martaneshit dhe si territor gjeografik i përket fshatit Lenë të njësisë administrative Martanesh. Këtu ka pasur shumë ekspedita që janë marrë me studimin e tij, kjo më shumë para viteve 90-t. Ky është liqeni më i madh dhe më i bukur me sipërfaqe prej 45 ha me gjatësi rreth 620 m dhe gjeresi 300 m.

#### LIQENET AKULLNAJORE TË BALGJAIT

Liqenet akullnajore të Balgjait, ndodhen në zonën e Dibrës, Bulqizës dhe Klosit me ujën e tyre të kristaltë dhe të freskët, përbëjnë një destinacion fantastik për të pasionuarit e natyrës malore dhe këdo që është në kërkim të një aratisje nga temperaturat e larta të verës.

Të ndodhura afro 1900 metra mbi nivelin e detit dhe të rrethuara nga pyjet halore e peizazhi alpin, liqenet akullnajore të zonës veriore janë gjithashtu të pasura në florë dhe faunë përreth.

Për të shkuar për tek liqenet e Balgjait mund të shfrytëzohen rrugët nga Selishta në Dibër, Vajkal dhe Kokërdhak në Bulqizë dhe nga fshatrat e Klosit nga ana e Matit. Dikur në këtë zonë kishte me dhjetëra stane me dele, ndërsa sot kanë mbetur shumë pak të tilla, kjo pasi të rinjtë po largohen dhe banorët e këtyre zonave nuk mbajnë më bagëti.

Liqenet megjithatë kanë mbetur pak të eksploruara për shkak të infrastrukturës së dobët.

#### "URA E VASHËS"

"Ura e Vashës" gjendet midis fshatit "Fshat" dhe Guri i Bardhë në Klos. Ajo ndërlidh dy brigjet e lumit Mat dhe ka qenë i vetmi mjet komunikimi në rrjedhën e sipërme të lumit të Matit. Ura është me një hark dhe në anën e djathtë të rrjedhës ka një dritare shkarkuese. Këmbët e saj janë vendosur në malin e Vërrithit dhe malin e Dishit.

"Ura e Vashës" nuk ka pasur këtë emër. Ajo quhej "Ura e Skurës" dhe e ka ndërtuar si vepër bamirësie Haxhi Harjulla Skura nga lagja "Mansaj" e Gurit

të Bardhë, afërsisht 300 vite më parë. Ajo i ka marrë emrin "Urës së Vashës" që gjendet jo shumë larg saj, në Sheun e Dishit dhe që sot quhet "Ura e Skurës". Duke qenë më e rëndësishme dhe emri "Ura e Vashës" më simbolik, ka përvetësuar këtë emër, duke u njohur si e tillë në gojën e kalimtarëve.

Familja "Sina" është e vetmja familje që jeton në fund të dy shpateve, një familje punëtore që mirëmban rrugën, të cilën e ka hapur vetë, dhe Urën e Vashës. Legjenda thotë se ka marrë këtë emër nga që një familje nga si Skuraj, që jetonte në Gur të Bardhë, kishte vetëm një vajzë, e cila nuk u martua se nuk kalonte dot lumin. Një ditë vasha vendosi që me pasurinë e saj të ndërtojë urën.

Ura e Vashës vizitohet nga shumë turistë shqiptarë e të huaj, madje edhe një tabelë e vogël ku shkruhet "Ura e Vashës" është vendosur nga turistë çekë. Bukuritë natyrore dhe vlerat historike të kësaj zone janë krejt të panjohura për shumë shqiptarë, jo më për të huajt. Por, me ndërtimin e rrugës së Arbrit, turistët priten të shtohen.

Aktualisht mund të përdoret edhe segmenti i përfunduar i Rugës së Arbërit nga Bulqiza për në fshatin Guri i Bardhë. Përgjatë kësaj rruge ka shtëpi karakteristike prej guri.



# Votimet e 30 qershorit në Bulqizë ishin një maskaradë!

**Z.Fiku, PS krijoi presion dhe klimë terrori gjatë muajit qershor në të gjithë vendin, në Bulqizë si është përcjellë kjo gjendje?**

Votimet e 30 qershorit ishin një farsë, të cilat në një kohë kur Shqipëria ka ndërtuar insitucionin e pluralizmit politik që në vitin 1991, kohë kur është votuar me garë shumëpartiake (pluraliste), zbuluan dhe njëherë produktin e vjetër politik të Partisë Socialiste (ish Partia e Punës), se ëndrra moniste nuk është larguar akoma nga praktika për të marrë pushtetin. 30 qershori ishte një shfaqje e rëndë e primitivitetit politik të kësaj force politike. Votimi ishte farsë, një votim që nxori zbuluar mbështetjen fiktive që Partia Socialiste ka në Shqipëri dhe në Bulqizë. PS përdori mjetet dhe forcën e pushtetit për të dërguar drejt qendrave të votimit të gjithë të punësuarit në administratën e bashkisë dhe njësitë e saj, punonjësit që varen nga drejtoria e shëndetit publik dhe drejtoritë e tjera, mësuesit, punonjësit e nëntokës, familjet me ndihmë ekonomike e të tjerë, duke iu kërkuar forcërisht për të votuar anëtarin e këshillit bashkiak dhe kryetarin e bashkisë. Akoma më e rëndë është gjetja e një numri fletësh votimi të konsiderueshme, të plotësuar nga votimi kolektiv apo komisioni në QV. Në rrethin e Bulqizës pjesëmarrja në votime, me gjithë këtë problematikë (presioni, shantazhi, detyrimi për të punësuarit në pushtetin lokal dhe sektorët e tjerë) nuk i kaloi 20 %.

Partia Demokratike dhe opozita ka evidentuar, se gjatë gjithë ditës së votimit komisionerët e qendrave të votimit, drejtuesit lokal dhe të institucioneve, kanë shantazhuar elektoratin votues, të punësuarit, duke iu kërkuar pjesëmarrjen e anëtarëve të familjes, të afërmit e tyre, pasi në rast të kundërt pasojat do të ishin me largim nga puna,



prerje të ndihmës ekonomike dhe konsequenca të tjera, që mund t'i shkaktojë vetëm një pushtet i egër dhe monist. Zgjedhjet e 30 qershorit ishin zgjedhje moniste. Si në gjithë vendin, votuesve iu është kërkuar për të raportuar të hënën, madje duke treguar shenjë në gisht si pjesëmarrës në votim. Pavarësisht kësaj maskarade, e cila nuk kishte asgjë me një ditë votimesh në një vend pluralist, hendeuku ku e gjeti veten votimi për pushtetin lokal në 30 qershor në Bulqizë ishte katastrofal, pasi në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2015 pjesëmarrja në votime ishte 58%, kësh-tu që maskarada mbetet maskaradë.

**-Jeni gjendur përballë një kundërshtari politik (PS), një mazhorancë që ka pushtetin, si e keni përballuar, duke ruajtur mbështetjen në njerëz dhe elektorat, në intelektualë dhe nivelet e tjera, të cilëve iu është dashur të përballen me pushtetin dhe mundësinë për të humbur vendin e punës?**

Së pari, si një parti e vlerave demokratike dhe themeluese e pluralizmit politik në Shqipëri pas një terri të dhunshëm 50 vjeçar, parimin fundamental të votës së lirë, në një shoqëri të lirë dhe në një garë pluraliste, duke respektuar institucionet themelore të shtetit nuk ndryshohen kurrë dhe as abuzohet me to. Në një shoqëri pluraliste gara është fondamenti, guri themeltar i shtetit.


Së dyti, Partia Demokratike drejtohet nga një lidhësi i formuar, shkolluar dhe me një praktikë perëndimore të shoqërisë së emancipuar të shteteve më të rëndësishme të Evropës. Praktishtë Lulzim Basha

është udhëheqësi politik më bashkëkohor, i cili në praktikën e punës së tij respekton parimet fundamentale të shtetit demokratik. Për një forcë politike, si Partia Demokratike, kjo është e rëndësishme.

Po ashtu, në vijim të betejës për votëm e lirë, një betejë e hapur që në vitin 2013, me ardhjen në pushtet të Partisë Socialiste dhe Edi Ramës në krye të qeverimit të vendit, deri me datën 28 Qershor, PD ka protestuar për të mos pranuar të zhvillohen zgjedhje fasadë, që me 30 qershor Partia Socialiste i ktheu në votime për veten dhe jo në zgjedhje. Sidoqoftë, Partia Demokratike sensibilizoi komuniktetin ndërkombëtar për atë që po ndodhte në një vend anëtar i NATO-s dhe në pritje të hapjes së negociatave me BE-në, e cila bashkëpunon me shtetet mbi bazën e parimeve demokratike.

Partia Demokratike/ Dega Bulqizë, duke mos patur komisioner dhe vëzhgues në KZAZ nr.18, QV dhe GNV, përmes strukturave të saja, nga më të mëdhatë tek më të voglat, në bazë fshati është organizuar për të vrojtuar QV mbi ecurinë e zhvillimit të votimeve dhe pjesëmarrjen. Nga të dhënat e mbledhura dhe rezultati i publikuar nga KZAZ nr. 18, ka përrputhshmëri dhe diferenca të konsiderueshme votash.

Në vëzhgimet tona, policia e shtetit ka qenë e angazhuar në fushatën elektorale në mbështetje të kandidatit të PS. Njerëzit tanë, anëtarët e PD-së, mbështetësit tanë janë treguar aktiv. Ne kemi qenë në krye të detyrës gjatë gjithë kësaj kohe, duke i treguar elektoratit tonë se këtë situatë skan-



**• Në KZAZ nr. 18, në QV dhe GNV, për vendet vakante të komisionerëve, të lëna nga KQZ-ja, pasi ajo nuk miratoi kërkesën e PDSH për të qenë pjesë e këtyre njësive, këto vende që duhej të zëvendësoheshin nga shoqëria civile, në të gjithë rastet, në Bulqizë janë zëvendësuar nga militantët të PS dhe nga të punësuar në administratën shtetërore, mbështetës të njohur të Partisë Socialiste**

daloze, terrorizuese dhe dhunuese ne mund ta përballojmë, siç dhe përballuam. Në Bulqizë, Partia Socialiste ka njohur gjendjen katastrofale ku ajo gjendet aktualisht. Dhe është po kaq e vërtetë kjo, sa vetë socialistët, duke qenë vetëm në komisione, në qendrat e votimit, në numrimin e votave, pra gjithë strukturën votuese (them votuese pasi ata nuk ishin zgjedhje) përsëri u "detyruan" të vjedhin, një ves i përjetshëm i tyre. Me këtë rast Partia Demokratike i dha provën elektoratit të saj në rritje, se ne së shpejti do të vijmë në pushtet. Ne kemi të dhëna të sakta për gjithë atë që është gjendja elektorale në Bulqizë. Dhe në këtë rast ne ditëm ta kthejmë në favorin tonë këtë situatë të rëndë. Socialistët shpejt do t'i lëshojnë institucionet dhe zyrat që kanë uzurpuar me dhunë dhe arbitrarisht.





# DEFRIM FIKU: Drejtorët e institucioneve shantazhuan vartësit

• Në Bulqizë sipas monitorimit të strukturave të PD-së, kanë shkuar në kutitë e votimit 7.077 vota, ndërsa sipas raportimit të KQZ-së në momentin e mbylljes së QV-ve (ora 19:00) janë raportuar 7500 vota. Raportimi i KZAZ-së nr. 18 në Bulqizë jep shifrën 8949 vota. Pra, siç shihet, nga shifra e monitorimit nga PD, në raportimin e KQZ-së në mbylljen e votimit dhe raportimi i KZAZ-së ka një diferencë të konsiderueshme prej gati 1900 votash

(Vijon nga faqja 1)

**- PS përdori pushtetin dhe institucionet që drejton për të afruar mbështetje dhe vota, ç'keni konstatuar në Bulqizë ju si Parti Demokratike?**

Si në gjithë Shqipërinë, PS me gjithë strukturat e saja të njohura politike, por dhe përmes strukturave kriminale, kryesisht atë të ekonomisë, ajo ka përdorur barbarisht dhe "dhunshëm" (me detyrim) administratën vendore, pasi siç dihet, në Bulqizë, kryetari i Bashkisë së Bulqizës Melaim Damzi, mandatin e pati marrë nën siglën e LSI-së, është daja i kandidatit të PS-së Lefter Alla, i shpallur fitues në maskaradën e 30 qershorit 2019.

Damzi dhe Alla ndërruan rolet në Bulqisë, pasi skema nepotike ka funksionuar nga dita e parë që Damzi pati marrë mandatin e kryetarit të Bashkisë së Bulqizës. Melaim Damzi e ka shfrytëzuar lidhjen e gjakut me Lefter Allën në çdo tenderim të bërë nga bashkia, që me siguri, pavarësisht ndërrim rolesh, ky bashkëpunim, tashmë Alla - Damzi do të vazhdojë dhe në të ardhmen, sa kohë kryetari i ri të jetë në krye të bashkisë Bulqizë. Historia e përfitimeve familjare tashmë është një praktikë e njohur në Shqipëri me Rilindjen e Edi Ramës në marrëdhënie të ngushta me sektin e oligarkëve, të cilët i kanë siguruar dhe i sigurojnë të ardhura Partisë Socialiste për të blerë dhe siguruar pushtet.

Në Bulqizë, këtë qytet dhe rreth me përfitime të mëdha ekonomike për oligarkët e pushtetit të Rilindjes, Edi Rama dhe strukturat e dhunshme të pushtetit politik dhe ekonomik, i lëshuan skifterë të shumtë mbi popullin e varfër dhe të papërfaqësuar, i cili mund të jetë një nga popujt më të varfër të vendit për shkakun e një qeverisjeje monstruoze vertikalisht dhe horizontalisht, nga pushteti qendror dhe ai vendor.

Ka dëshmi të shumta publike, se drejtori i minierës Petrit Cara dhe kunati i tij Asllan Daxha (drejtor i zyrës së punës i cili ishte kryetar i KZAZ nr. 18 në Bulqizë, i cili më pas dha dorëheqje), kanë ushtruar presion të jashtëzakonshëm të punëtorëve e minierës së kromit, familjeve të tyre, që ata detyrimisht duhet të shkonin në votime, dhe t'a dëshmonin këtë bashkë dhe me familjet e tyre. Petrit Cara ishte edhe kandidati për këshilltar bashkie nën siglën e partisë së gjelbërt, i cili ka siguruar një mandat me 494 vota, pra që të punësohesh në miniere duhet të takosh dhen-drin dhe me pas të shkosh të Miku, ku me problemet logjistike merret dhen-dri, jo vetëm për minieren por edhe për problemet e tjera, pasi ky zotnia është edhe sekseri i Kryetarit të PS.

Në Bulqizë, një zonë që spikat ndjenja arsim-dashëse tradicionale për dije dhe kulturë, nuk ka trishtim më të madh, kur mëson si është vepruar nga drejtuesi i Zyrës Arsimore Bulqizë Kujtim Kërkuti, njëkohësisht dhe anëtar i KZAZ nr. 18, i cili ka abuzuar rëndë duke përdorë autoritetin që i jep detyra



shtetërore, duke i detyruar të gjithë punonjësit vartës për t'iu drejtuar QV. Kërkuti në kundërshtim të plotë me ligjin, ka angazhuar të gjithë drejtorët e shkollave, vartësit e tij të tjerë që të ndjekin mësuësit, familjet e mësuësëve dhe vartësit e tyre për pjesëmarrjen në votime, ndryshe ata humbin vendin e punës në rast mospjesëmarrje në votime.

Po ashtu, shembull abuzimi i presionit dhe terrorit elektorale në Bulqizë është dhe Flamur Meta, drejtor i Shëndetit Publik Bulqizë, i cili në shkelje të ligjit ka qenë i angazhuar në ndjekjen e procesit të votimit, duke përdorur pozitën shtetërore, për të siguruar pjesëmarrjen e punonjësve të drejtorisë që ai drejton, për shkakun se si arsimi dhe shëndeti publik ka një mundësi favorizuese për të afruar njerëz në votime. Tjetër drejtor i angazhuar ishte ai i OSHE, Edmond Visha, i cili së bashku me Drejtorin e Zyrës së punës, kanë qenë drejtues edhe me pushtetin PD-së për vite me radhë, besoj që këta dhe disa të tjerë punonjës të Policisë futen në grupin e sahanlëpirësëve dhe bëjnë gjithçka për të qëndruar në pushtet. Në të gjithë rastet këto praktika të dhunshme kanë qenë në shkelje të ligjit elektorale dhe për këtë arsye Dega e partisë Demokratike Bulqizë, po mbledh prova dhe fakte dhe do t'i drejtohet organit të akuzës.

Votimet e thirrura nga Edi Rama dhe Rilindja në 30 qershor, do të mbahen mend për dhunimin spektakolar të pluralizmit politik në një vend dhe në një shoqëri pluraliste. Është një rast unik, jo vetëm në Evropë, por dhe në botë. Dhe diktatura kishte rregullat e saja në votime. Partia Socialiste, KQZ-ja e Partisë Socialiste i shndërruan në votime të partisë së tyre. Asnjë gjë nuk thotë rezultati katastrofal i këtyre votimeve. Kutitë i sollën vetë, votat u numruan vetë, vëzhguesit i bënë vetë, fletët i futën vetë dhe përsëri katastrofa e tyre "shpërtheu" nga mjedisi i tyre si

një murtajë, si një epidemi, si një sëmundje e rëndë të cilën nuk ka arritur ta shërojë në vetvete Partia Socialiste.

Kështu, në KZAZ nr 18 edhe në QV dhe GNV, për vendet vakante të komisionerëve, të lëna nga KQZ-ja, pasi ajo nuk miratoi kërkesën e PDSH për të qenë pjesë e këtyre njësive, këto vende që duhej të zëvendësoheshin nga shoqëria civile, në të gjithë rastet, në Bulqizë janë zëvendësuar nga militantë të PS dhe nga të punësuar në administratën shtetërore, mbështetës të njohur të Partisë Socialiste.

**-Më 30 qershor, në kundërshtim me dekretin e presidentit, i cili i kishte anuluar në këtë datë dhe në rrethin tuaj është votuar. Për ju ka qenë një ditë e lodhshme dhe me shumë aspekte. Si kaloi 30 qershori në aktivitetin politik të kryetarit të Partisë Demokratike?**

Moszbatimi i Dekretit të Presidentit për anulimin e zgjedhjeve të 30 qershorit është një problem madhor në një vend demokratik, i cili aderon si një vend demokratik në forumet dhe konventat ndërkombëtare mbi bazën e parimeve të funksionimit të pluralizmit demokratik. Ky fakt ishte një detyrë shtesë për Partinë Demokratike, e cila ka protestuar që në fillim-vitin 2019 për çështjen e votës së lirë në një problematikë të gjerë. Ne e dinim se në votimet e 30 qershorit Partia Socialiste do të abuzonte, madje rëndë, pasi ajo ka humbur reputacionin publik në Shqipëri dhe në perëndim. Ne, si Partia Demokratike duhet ta faktionim këtë maskaradë.

Kështu, strukturat e PD-së të degës kanë monitoruar të gjithë procesin dhe kanë konstatuar shkelje të rënda mbi procesin administrativ të votimeve. Komisionet e votimeve janë ngritur me punonjës të administratës së bashkisë, nga administrata shtetërore, mësuës e të tjerë, të njohur si mbështetës të Partisë Socialiste. Procesverbali i mbajtjes

së mbylljes së procesit të votimit dhe procesverbali i mbylljes së kutisë është mbajtur në KZAZ nr. 18.

Por, siç ka ndodhur dhe me 99 mijë qytetarë shqiptarë në të gjithë Shqipërisë, të cilët e shprehën revoltën e tyre duke shkuar me detyrim në kutitë e votimit, por duke e demaskuar rregjimin me shënime nga më të ndryshmet në fletë e votimeve, dhe qytetarët e Bulqizës, e kanë shprehur revoltën e tyre me anë të mesazheve në fletën e votimit duke e nxjerrë zbuluar dhe diskretituar rregjimin. Kjo masë e konsiderueshme votuesisht janë një alarm i madh për politikën shqiptare dhe komunitetin ndërkombëtar, të cilët njoftojnë diktatin dhe abuzimin që pushteti i Rilindjes dhe Edi Ramës i kanë bërë kësaj pjese të administratës shqiptare, e cila është kërcënuar nga pushteti dhe hierarkia kriminale e tij. Në Bulqizë numri i fleteve të votimit të pa vlefshme është 716.

**-Tashmë votimet e 30 qershorit janë ekspozuar përballë problematikave të shumta, në rrethin e Bulqizës ç'ka ndodhur?**

Në rrethin e Bulqizës ka ndodhur ajo që ka ndodhur në gjithë Shqipërinë, fenomeni i fletëve të votimit është më i madh se ai i raportuar. Babëzia e vjedhjes dhe egërsia për pushtet ka bërë që komisionerët që kanë futur fletëvotimi në kutitë e votimit nuk kanë mundur t'i rakordojnë manipulimet e kryera duke krijuar një kakofoni shifrash me diferenca të konsiderueshme nga votimi në fakt dhe sipas raportimeve të institucioneve zgjedhore. Natyrisht, kjo është një situatë që i vjen në ndihmë opinionit dhe fakteve që Partia Demokratike ka interpretuar dhe po interpreton çdo ditë, se si është abuzuar me votimet dhe zgjedhjet në Shqipëri, të paktën që nga viti 2015.

Në Bulqizë sipas monitorimit të strukturave të PD-së, kanë shkuar në kutitë e votimit 7.077 vota, ndërsa sipas raportimit të KQZ-së në momentin e mbylljes së QV-ve (ora 19:00) janë raportuar 7.500 vota. Raportimi i KZAZ-së nr. 18 në Bulqizë jep shifrën 8 949 vota. Pra, siç shihet, nga shifra e monitorimit nga PD, në raportimin e KQZ-së në mbylljen e votimit dhe raportimi i KZAZ-së ka një diferencë të konsiderueshme prej gati 1900 votash, një numër i konsiderueshëm, i cili luan rol të madh dhe në qytetet e kategorisë së parë. Në këtë hapësirë "lëviz" dhe krimi elektorale, vesi dhe abuzimi vulgar i partisë socialiste, kur janë dhe vetëm në votime. Është kaq i lexueshëm vesi i tyre në punën e vjedhjes, grabitjes dhe blerjes së votave, sa ata vjedhin dhe vetveten, dhe nuk i besojnë dhe vetes. Paradoksale. Për këto shkelje të konstatuara janë kallëzuar penalisht komisionerët e QV-ve, GNV-ve dhe KZAZ-së nr. 18 në Bulqizë si dhe do përgatitet kallëzim penal pranë organit të akuzës për të gjithë titullarët e mësipërm.

**Intervistoi: Oleg HANKU**



Bashkia e Bulqizës ka një sipërfaqe prej 694 km<sup>2</sup>. Gjithë territori i bashkisë shtrihet nga 300 m, deri në 2000 m lartësi mbi nivelin e detit.

studimi

*Bashkia e Bulqizës ka një sipërfaqe prej 694 km<sup>2</sup>. Gjithë territori i bashkisë*

# POZITA GJEOGRAFIKE DHE RESURSET

*Oferta gjeografiko-natyrore është një nga elementët e rëndësishëm të zhvillimit turistik. Potenciali natyror përbën bazën e potencialit*

Bashkia e Bulqizës shtrihet në rajonin verilindor të Shqipërisë. Në koordinatat 41°03' gjërësi gjeografike veriore (njësia administrative Shupenzë), 41°21'30" gjatësi gjeografike veriore (njësia administrative Trebishtë), 20°18'50" gjërësi gjeografike lindore, 20°07'30" gjatësi gjeografike lindore (njësia administrative Martanesh).


Në veri kufizohet me bashkinë Dibër, në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jug-perëndim me bashkinë Tiranë, në jug me bashkinë Librazhd dhe në perëndim me bashkinë Klos. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bulqizës. Gjatësia e vijës kufitare është 120 km. Nga këto gjatësia e vijës kufitare me bashkinë e Dibrës është 25 km, me bashkinë e Librazhdit 29 km, me Republikën e Maqedonisë 30 km, me bashkinë e Klosit 23 km dhe me bashkinë e Tiranës 13 km.

Bashkia e Bulqizës ka një sipërfaqe prej 694 km<sup>2</sup>. Gjithë territori i bashkisë shtrihet nga 300 m, deri në 2000 m lartësi mbi nivelin e detit. Bashkia e Bulqizës ka në përbërje 7 njësi administrative të cilat janë: Bulqizë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Gjoricë, Ostren dhe Trebisht.

Oferta gjeografiko-natyrore është një nga elementët e rëndësishëm të zhvillimit turistik. Potenciali natyror përbën bazën e potencialit turistik primar pasi ai ka të bëjë si dhe në farë mënyre mjedisi gjeografik natyror ndikon në zhvillimin e turizmit në bashkinë Bashkisë.

**NDËRTIMI GJEOLOGJIK DHE GJEO MORFOLOGJIK I BULQIZËS**

Nga pikëpamja gjeologjike, Bulqiza, bën pjesë në zonën tektonike të Mirditës dhe në zonën tektonike të Krasta-Cuka-



lit, e cila shtihet në formën e një rripi nga Labinoti në Dibër. Ndërtimi gjeologjik i Bulqizës përfaqësohet nga shkëmbinj të magmatik në masën 65% si dhe ato terrigjen dhe sedimentar. Kjo larmi litologjike kushtëzon coptimin e madh horizontal dhe vertikal, kontrastet e theksuara hipsometrike si dhe tipet e shumtë të relievit litologjik. Strukturat janë të shumëllojshme dhe të ndërlikuara.

Në formimin e veprave strukturore të zonës, rol të rëndësishëm kanë luajtur lëvizjet e fuqishme diferencuese (ngritëse dhe ulëse), ku si rezultat i tyre kemi shfaqjen e horsteve dhe grabeneve, të cilat janë të përfaqësuara nga malet përrreth dhe luginat. Në këtë zonë mund të themi se relievi është më shumë rezultat i tektonikës shkëputëse sesa asaj rrudhosëse. Por gjithashtu në bashkinë e Bulqizës ndodhet dhe shkëputja tektonike me drejtim të kundërt me ato normalet (veriperëndim-juglindje), por jugperëndim-verilindje, e cila përfaqësohet nga thyerja Qafë Buall-Bulqizë-Vajkal.

## RELIEVI

Bashkia e Bulqizës karakterizohet nga një reliev kodrinor-malor. Si rezultat

i larmisë litologjike-strukture si dhe faktorëve të morfodinamikës së jashtme (klima dhe hidrografia), bashkia e Bulqizës ka një reliev të larmishëm ku malet janë të gërshetuara me luginat. Në nënjesitë e relievit të Bulqizës përmendim: malin e Lopës, mali e Homeshit, mali i Dhoksit, mali i Kaptinës, lugina e Bulqizës, lugina e Planit të Bardhë, lugina e Valit etj. Në përgjithësi mbizotëron relievi i lartë mbi 1000 m. Përsa i përket llojeve të relievit, janë të pranishëm relievi strukturo-eroziv, relievi karstik, relievi eroziv-denuedues si dhe relievi akullnajor.

Relievi strukturo-eroziv është i përfaqësuar nga horstet dhe grabenet, të cilat, siç e theksuam dhe më lart, janë rezultat i lëvizjeve diferencuese vertikale (shkëputëse). Relievi karstik është i përhapur më shumë në pjesën jugperën-

Malësia e Martaneshit ka peizazh akullnajor, veçanërisht në lartësi mbi 1500-1600 m, me liqenet akullnajorë si: liqeni i Zi, liqeni i Bardhë, i Dhoksit etj. Përveç malit të Lopës, Dhoksit, ngrihen edhe maja të tjera si Kaptinës (1873 m), Tri Gjejurave (1774 m). Luginat më karakteristike janë: lugina e Batrës, Theknës, Lenës. Ndërtimi gjeologjik i kësaj lugine është kryesisht nga magmatikët

Malësia e Gollobordës shtrihet në pjesën lindore të bashkisë të Bulqizës. Karakterizohet nga një reliev i valëzuar me kurrize të ulëta dhe të gërryera nga erozioni i përrrenjve. Luginat në këtë malësi kanë pamjen e gropave të mbyllura e të sheshta, si: fusha e Klenjës, Sterblevës dhe Studnës si edhe lugina e Okshtunit. Ndërsa në pjesën lindore



dimore të rrethit të Bulqizës, ku dhe masivet karbonatike janë më të përhapura. Ndërsa relievi akullnajor është i përfaqësuar nga format akullnajorë siç janë morenat dhe liqenet akullnajorë (liqenet e Balgjajt, liqenet e Kasnisë, liqeni i Zi etj.)

Lugina e Bulqizës dhe e Planit të Bardhë ndahen mes tyre nga qafa e Buallit. Lugina e Bulqizës i përket pellgut ujëmbledhës të Drinit të Zi, ndërsa ajo e Planit të Bardhë pellgut të Matit. Lugina e është formuar nga shkëputja tektonike, e cila kalon tërthor masivit ultrabazik të Bulqizës. Ka një gjatësi rreth 25 km dhe gjendet në lartësinë 600-800 m mbi nivelin e detit. Lugina rrethohet nga shpate malore të thepisura. Ajo përbëhet nga sektori i sipërm dhe sektori i poshtëm, të cilat kanë tipare të veçanta morfologjike.

Sektori i sipërm është i përfshirë nga lëvizje ulëse, gjë e cila dëshmohet nga depozitimet proluviale-aluvionale kuaternare, mungesa e tarracave lumore, karakteri i rrafshët i saj etj. Në sektorin e poshtëm (Vajkalit) lugina ngushtohet dhe vende-vende merr formën e grykës. Aty shfaqen dhe nivelet e tarracave, lugina bëhet më e drejtë, që lidhet me përfshirjen e këtij sektori nga lëvizjet ngritëse. Zgjerohet pasi bashkohet me Zallin e Okshtunit dhe hyn në zgjerimin e madh të Dibrës. Në këtë luginë, sidomos në sektorin e sipërm të saj, ka kone të depozitimit fluvio-glaciare, sepse përrrenjtë vazhdojnë të sjellin sasira të mëdha materiale.

shtrihet vargmali i Raducit (2064 m) dhe maja e Zezë (2257 m).

Zgjerimi i Dibrës ndodhet në lartësinë 400-500 m mbi nivelin e detit dhe ka një gjatësi prej 8 km dhe gjersi 4-5 km. Pjesë e këtij zgjerimi në bashkisë e Bulqizës janë fushat dhe kodrat e Shupenzës dhe Gjoricës, me një reliev fushor e kodrinor të valëzuar. Gjenden të përhapura tokat e kafejta, të kafejta livadhore dhe aluvionale (të formuara nga depozitimet e prurjeve të ngurta të lumenjve).

## KLIMA

Në bashkinë e Bulqizës dallohet zona klimatike mesdhetare paramalor dhe mesdhetare malore e cila karakterizohet nga dimër i ftohtë me temperatura nën 0 gradë C dhe me reshje të pakta.

- Temperatura mesatare shumëvjeçare është 11.4 gradë C
- Temperatura mesatare shumëvjeçare e korrikut është 19.3 gradë C, e janarit është 1.1 gradë C.
- Temperatura më e lartë është regjistruar 38 gradë C.
- Temperatura më e ulët e regjistruar është -22 gradë C.

Klima e kësaj luginë është mjaft e ftohtë, gjë e cila lidhet jo vetëm me lartësinë e madhe mbi nivelin e detit, por dhe me erën e fortë që fryn. Duke qenë e hapur nga lindja, nëpër të depërton mur-lani nga lugina e Drinit të Zi. Këtu erërat lindore kanalizohen dhe forcohen dhe vazhdojnë rrugën për në luginën e Matit, pasi Qafa e Buallit ka lartësi të vogël rel-





# studimi

Bashkia e Bulqizës është mjaftë e pasur me bimë dhe kafshë. Shpërndarja e tyre kudo në male, kodër, luginë, fusha etj, është mjaft e larmishme në numër e në lloje.

*shtrihet nga 300 m, deri në 2000 m lartësi mbi nivelin e detit*

## TURISTIKE TË BASHKISË BULQIZË

*turistik primar pasi ai ka të bëjë si dhe në çfarë mënyre mjedisi gjeografik natyror ndikon në zhvillimin e turizmit në bashkinë Bashkisë*



ative. Prandaj në luginën e Bulqizës dhe në Qafën e Buallit pothuajse vazhdimisht fryn erë. Kjo luginë përshkohet nga Zalli i Bulqizës që merr degë të shumta nga e majta dhe e djathta, dhe derdhet më pas në Drinin e Zi.

Reshjet në këtë rreth janë nën mesataren e vendit. Mesatarja vjetore shumëvjeçare arrin 1187 mm në vit. Stina më e lagësht është dimri (dhjetori). Muajt më të thatë janë korriku dhe gushti. Pjesa më e madhe e reshjeve bie në formën e dëborës. Ditët me reshje gjatë vitit zgjasin 120 ditë nga këto me dëborë deri në 40 ditë. Era më dominuese veçanërisht për luginën e Bulqizës është Murlani, një erë e thatë kontinentale dhe karakteristike për këtë zone. Drejtimi i saj kryesor është lindja. Meqë vjen nga kontinenti është e thatë dhe e ftohtë dhe në situata të caktuara sinoptike është e fortë, duke shkaktuar shpesh dëme dhe duke sjell temperaturë shumë të ulëta. Krahas "murlanit" tipike për zonën janë edhe erërat e shpatit, luginës me emërtime të ndryshme sipas fshtarave apo krahinave.

### HIDROGRAFIA

Bulqiza paraqitet me një rrjet hidrografik mjaft të pasur. Lumi kryesor që rrjedh në territorin që përfshin kjo bashki është Drini i Zi. Lumi Drin përshkon 6.85 km në territorin e bashkisë Bulqizës. Ky lum buron nga liqeni i Ohrit, pas daljes nga ky liqen në qytetin e Strugës vazhdon rrugën nëpër një sërë grykash të ngushta të cilat mbarojnë në Urën e Spilesë. Arteri kryesor i Drinit, pasi kalon në kufijt shtetëror të vendit është Zalli i Bulqizës. Zalli i Bulqizës, i cili buron në liqenet e Balgjajt, merr me vete shumë përrenj të vegjël e përroska. Formohet nga bashkimi i ujërave të përroit të Okshtunit dhe përroit të Dushajit. Ky lumë e ka gjatësinë e shtratit 46.5 km, sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës 484 km<sup>2</sup>, lartësinë mesatare 1150 m dhe rënie 25m/km.

Zalli i Okshtunit ka fillimin e tij në serinë e përrenjeve malorë që zbresin nga shpatet VL të maleve të Mirakës (1751 m) dhe Kaptinë (1873 m). Përroi i Dushaj formohet nga bashkimi i rrëkeve që zbresin nga shpatet lindore të malit të Lopës (2020 m) si dhe nga shpatet perëndimore të malit të Alamanit (2097 m). Pas kësaj ujrave të përroit të Dushaj

rrjedhin në drejtim lindor të cilin e ruajnë deri në bashkimin me ujërat e Zallit të Okshtunit. Pas këtij bashkimi ai merr emrin Zalli i Bulqizës. Ky lumë vazhdon të rrjedh në drejtim verior dhe derdhet në Drinin e Zi.

### TOKAT

Tipet e tokave që shtrihen në bashkinë e Bulqizës janë:

Tokat e kafejta, kjo kategori tokash shtrihet në lartësinë nga 600-1000 m mbi nivelin e detit. Këto toka formohen mbi shkëmbinjtë sedimentarë dhe shumë pak mbi ato magmatik e metamorfik. Nga formacionet sedimentare më të përhapura janë shtufet ranore, ranorët e shkrifët, argjilat, konglomeratët etj. Këto toka vendosen mbi eluvën e separatinës dhe magneziteve gjysmë të alteruara. Përhapjen më të madhe këto toka e gjejnë në komunën Shupenzë, në komunën Martanesh.

Toka të kafejta livadhore (KL), këto toka cilësohen edhe si toka kalimtare, sepse përbëjnë brezin e kalimit midis tokave të kafejta dhe atyre livadhore të kafejta, si nga prejardhja ashtu edhe nga cilësia e tyre. Janë të pasura me Ca të këmblyeshëm, përmbajnë më pak humus se tokat e kafejta rreth 3-5 %.

Tokat livadhore malore, kjo kategori toke formohen nën ndikim e klimës mesdhetare malore, me temperaturë relativisht të ulët dhe reshje të shumta. Bimësia karakteristike e këtyre tokave është ajo barishtore dhe leguminoze. Karakteristikë e tokave livadhore malore është horizonti humusor shumë i zgjatur, përqindja e humusit shkon nga 1.5 % - 20 %. Këto toka hasen më shumë në zonën e Martaneshit.

Toka të murrme pyjore, tokat e këtij brezi të zonalitetit vertikal shtrihen në lartësinë 1000-1600 m mbi nivelin e detit. Formohen nën ndikimin e klimës mesdhetare paramalore. Këto toka formohen mbi formacione sedimentare ranore, gëlqeror masiv dhe ultrabazik. Përhapjen më të madhe këto toka e gjejnë në malësinë e Martaneshit dhe atë të Gollobordës.

Tokat torfike (kënetore), këto toka janë të përhapura në shumë zona të vendit tonë. Në rrethin e Bulqizës këto toka gjenden në fushën e Bulqizës. Kanë profil pedologjik të diferencuar dhe kanë

kapacitet të lartë ujorë.

Tokat aluvionale, këto toka formohen si rezultat i veprimtarisë gjeologjike të lumenjëve. Vendosen zakonisht mbi formacione aluviale të vjetra dhe të reja, të përbëra nga rëra, zhavori dhe zalli i lumit. Këto toka ndikohen edhe nga bimësia barishtore dhe ajo livadhore. Në formimin e tyre ndikojnë njëkohësisht edhe kushtet klimatike, relievi dhe faktori biotik. Ky tip toke është më përhapur në zonë e Shupenzës dhe Gjoricës.

### BIODIVERSITETI

Bashkia e Bulqizës është mjaftë e pasur me bimë dhe kafshë. Shpërndarja e tyre kudo në male, kodër, luginë, fusha etj, është mjaft e larmishme në numër e në lloje. Në qytete (Bulqizë e Kraste), bimësia brenda qytetit është e kultivuar, kryesisht bimë dekorative si: bredhi, pisha, bliri, akacia etj. Mbjellja e këtyre pemëve dekorative ka filluar të aplikohet edhe në qendrat e komunave. Bashkia Bulqizës dallohet për një mbulesë bimore mjaftë të pasur në sasi dhe në lloje. Kjo mbulesë bimore përfaqësohet nga :

- Kati i dushqeve dhe shkurreve ( 800-1100 m ) zë vendin e dytë për nga sipërfaqja pas atij të ahut, ku mbizotëron dushku, lisi, qarri etj.
- Kati i ahut ( 1200-1800 m ) ka shtrirjen më të gjerë, druri më i përhapur është pisha e zezë dhe bredhi i bardhë.
- Kati i kullotave alpine ( mbi 1800 m )

Kati i dushkut shtrihet në formën e një brezi midis lartësive 800-1000 m, vjen i dyti për nga sipërfaqja që zë pas atij të ahut. Zona e dushkut është e organizuar edhe në trajtë masivesh sidomos në Zerqan, Sopot, Klenjë etj. ku mbizotëron kryesisht dushku, lisi, qarri etj.

Shtrirjen më të gjerë e ka kati i ahut dhe i halorëve, që shtrihen në lartësinë deri në 1200-1800m mbi nivelin e detit. Druri më i përhapur i këtij brezi është pisha e zezë dhe bredhi i bardhë. Si shtrirje përhapjen më të madhe e ka në Bajgjaj, malin e Bardhë, Dhoks, Tërnovë etj.

Kati i fundit bimor i përhapur në këtë zonë është ai i kullotave alpine. Shtrirja e këtij kati fillon në lartësitë mbi 1800 m, dhe janë sipërfaqe toke me bimë barishtore, që shtrihen mbi kufirin më të lartë të pyjeve dhe shërbejnë si kullotë për bagëtitë e imëta.

Edhe ndikuar edhe nga larmishmëria e formave të relievit dhe zonalitetit bimor, rrethi i Bulqizës karakterizohet edhe nga një botë shtazore mjaft e pasur. Malet përreth kanë qenë dhe janë (krahas dëmtimeve të shumta nga gjuetia pa kriter) të pasura me kafshë të mëdha mishngrënëse, si të tilla mund të përmendim: ujku, dhelpra, macja e egër, lakuriqi i natës etj. Ndërsa si barngrënës më të përhapur janë: lepuiri, iriqi, breshka, urithi etj. Gjithashtu bota shtazore pasurohet edhe me lloje të tjera si: kërmilli, zhapiku, hardhuca, zhaba, nëpërka etj. Ka edhe lloje shpendësh shtegëtar dhe joshtegëtar si: trumcaku, harabeli, gushkuqi, gushverdhi, dallëndyshja etj.


### PËRDORIMI I BURIMEVE NATYRORE DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Bashkia Bulqizë ka burime natyrore të pasura e të shumëllojshme duke ofruar një peizazh të bukur kryesisht malor, me pyje e kullota masive, me ujëra sipërfaqësore e nëntokësore, kjo natyrë e begatë të fton e të bën optimist për mundësitë e "zhvillimit të qëndrueshëm" të kësaj njësie. Ndërhyrja e njeriut në mjedis ka qenë e ndryshme në periudha të ndryshme kështu gjithmonë e më shumë mbi pyje po ndërhyhet duke zvogëluar sipërfaqet pyjore. Nga ana tjetër po degradohen së tepërmi dhe tokat, përdorimi pa kriter i pesticideve dhe i plehrave kimike po degradon ato së tepërmi, por ndodh dhe një fenomen i kundërt ato lihen djerrë të papunuara duke hapur vatra të tjera erozioni dhe duke rritur shpejtësinë e erodimit dhe dezertifikimit të tyre.

Sot është e vështirë të gesh një sipërfaqe brenda kësaj zonë që të mos jetë ndryshuar nga dora e njeriut, mjedisi po antropizohet me shpejtësi, njeriu po e kthen gjithçka të natyrës në favor të tij pa marrë parasysh ligjësitë dhe rregullat që veprojnë aty duke rrezikuar shumë sidomos gjeneratat e ardhshme, pasi me këtë "katastrofë" që po bëhet aktualisht sidomos mbi pyje dhe tokat bujqësore brezave në vazhdim do tu trashëgohet një katastrofë e madhe mjedisore pasi ne po e çojmë këtë ambient këtë ekosistem në një katastrofë ekologjike, prandaj duhet që sa më shpejtë që të jetë e mundur të merren masa rrënjësore, radikale për të ndaluar këtë ndërhyrje pa kriter,

- Të kultivohen sa më shumë fidanishte,
- Të ruhet rreptësisht fauna, të ndalohet gjuetia
- Të shpallen sa më shumë zona të mbrojtura

Ne duhet të bëjmë sa më shumë fushata ndërgjegjësimit për gjithë popullsinë që të bëhemi të gjithë të ndërgjegjshëm për të mos dëmtuar por për të mbrojtur të gjithë bashkë këtë mjedis kaq të bukur që na ka falur natyra dhe mbi të gjitha le ta trashëgojmë dhe tek brezat e ardhshme një mjedis të pastër të këndshëm dhe të pa cenuar nga askush.





Qielli, përgjithësisht i kaltër, si i kuqerremtë anash dukej si një saç madhështor mbi këtë fushë

letrat

# Tregim për një të mbytur



**AGIM DEMIRI**

**F**usha e Zvezës ishte shumë e gjerë dhe e rrafshët, aq sa nuk matej me sy. Njëpër këtë fushë kryqëzonin rrugë të ngushta e të gjera me baltë dhe pluhur deri në gju sa mezi kaloheshin, që ngrihej shtëllungë pas shtëllunge, në kohë të thatë vere. Qielli, përgjithësisht i kaltër, si i kuqerremtë anash dukej si një saç madhështor mbi këtë fushë. Gati e ndante përgjysmë një kanal i gjerë dhe ujëshumë. Më përpara kishte pasur një urë që lidhte dy brigjet e tij, por, që kishte ca kohë, që ishte prishur..

Vinin të vegjlit, duke çarë baltën deri te bregu dhe pasi shikonin një copë herë ujin e këtij kanali kthenin nga kishin ardhur. Po kështu edhe pleqtë ... Ndërsa të rinjtë e fuqishëm, vinin, merrnin duft dhe e kapërcenin me hovje nga ana në anë.

Një ndër ato, që kishin ardhur dhe donin të kalonte, ishte edhe Torum Spuhu një gjysmë i moshuar. Ai si dhe të gjithë, mezi kishte kaluar këto baltëra dhe me qeleshën dhe shkopin e tij, ishte gjetur pranë këtij kanali. Kishte kohë, që rrinte në qosh të tij, duke parë ujin e turbulluar, që mezi dukej nga afër se ecte .

Kishte disa ditë, që kishte ardhur për të kaluar matanë, por nuk ia kishte marrë mendja, ndaj ishte kthyer. Duhej të kalonte patjetër, në një mënyrë a në një tjetër, prandaj ishte në hall se si të bënte. Herë mendonte se edhe ai e kalonte kështu e herë se nuk mund ta kalonte...

-Si të bënte ?

- Po pse e kishin prishur urën xhanëm ?

-Pse nuk e rindërtonin ?

Shikonte më të rinjtë, që e kapërcenin kështu, me duftin e tyre dhe mendonte të bënte dhe ai kështu. Besonte se e kalonte.

Mori edhe ai hov dhe u hodh ...Por ... sapo i prekën këmbët në qosh për pak, që nuk arritën të shkojnë më tutje, i rreshitën dhe ...ra brenda në ujin e ftohtë të kanalit. Mezi mbahej në anën e tij për një rënje, shkurreje a seç ishte, duke iu dukur vetëm koka jashtë dhe mezi po mbahej

-Ojt dej, orekujej! - nisi të thotë me vete i shqetësuar dhe i shtrënguar nga uji, -Sak po mbytem... Ndjeu se këmbët po i rrëshqisnin gjithmonë e më thellë dhe fuqitë e krahëve, që e mbanin në anë po e linin dhe koka po i fundosej gjithmonë e më tepër në ujë ... Dmth nga çasti në çast po e shikonte vetën, të mbytur në ujë ...Jeta edhe pse i moshuar, i dhimbsej, po ç' të bënte ? E zuri ky rrezik...

-Ndihamë ! Ndihamë ! - filloi të thërrasë me zë të lartë e të çjerrë: Ndihamë se po mbytem !

Zërin e tij e dëgjonin larg dhe afër njerëz të ndryshëm, që dilnin nëpër ballkonet e shtëpive a dritare të shikonin se ç'po ngjaste dhe kthenin brenda, duke thënë në mënyrë shpërfillëse "se dikush kishte rënë në kanal dhe po kërkonte ndihmë se po mbytej. Zëri çante ajrin gjithmonë e më i lartë e i çjerrë, po njerëzit mbyllnin dritaret, veshët ...sikur të mos kishin dëgjuar asgjë ...sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Madje, ndonjeri zgërdhihej me turinjtë vesh me vesh se po i dilte profecia se kishte thënë dikur se "dikush do të mbytej në këtë kanal pa urë"; Mjerë kush do ta kishte kështu - thonin ata ... Dhe ja, tani ! Dikush tjetër thoshte se kjo mbytje do ta bënte një të mirë se njerëzit do të kujtoheshin se kishte pasur një urë; se duhej dhe do të ndërtonin një urë.

-Të ishte mbytur më parë meqenë do të kishte dalë e zgjidhur më parë ky problem ... Zërin e tij duke kërkuar kështu ndihmë e kishte dëgjuar dhe i pari i vendit duke luajtur shah me zëvendësin e tij, kishte bërë veshet pipëz për të dëgjuar më mirë dhe ishte shprehur si për të dhënë përfundimin e një problemi, që

mezi e kishte zgjidhur: "Do të jetë ndonjë duke u mbytur!"...

- Shah !

-Shah -sheh ...! -i ishte përgjigjur tjetri si të ishte zgjuar nga një ëndërr e tmerrshme...

Toruni thirrte sa mundte , duke kërkuar ndihmë në këte rrezik mbytje. Njerëzit e dëgjonin afër se çfarë kërkonte ajo britmë ...Ato më larg dëgjonin një krau-krrau të pakuptueshme dhe pyesnin njeri-tjetrin me kureshtje. Si përgjigje merrnin nga ato, që e dinin se dikush, po kërkonte ndihmë se po rrezikohej të mbytej ...Njerëz të ndryshëm afroheshin, pasi mezi dilnin nga balta gati gjer në brez dhe çuditëshin me çfarë shikonin

-Ej, qenka duke u mbytur një njeri ! - thonin fëmijët dhe largoheshin në punën e tyre

-Afshanjeraunë për këtë, që po mbytet !- thonin gratë dhe largoheshin të dëshpëruara.. Vinin edhe çiftet, ku burrat i kishin marrë gratë e reja në krah për t'i nxjerrë nga balta dhe pa marrë frymë akoma shikonin Torunin, që thirrte kështu dhe duke u tmerruar luftonte me mbytjen, që po i vinte nga çasti në çast.

-Pse thirr ? - i thoshte burri sikur nuk e dinte.

-Kërkoj ndihmë se po mbytem!

-Pse ke hyrë atje, morë xhajë ?

-Ju lutëm më jepni dorën të dal !

-Më vjen keq po nuk mundëm se ... po, sikur të bie edhe unë brenda, duke të nxjerrë ty? Jo, se ka më shumë mundësi të më tërheqësh ti mua brenda dhe të mbytem edhe unë? Se nuk thonë kot: - I mbytyri të mbyti! Po, edhe po nuk u mbyta, më prishet kostumi...

-Po më shpëto, more se të ndihmon edhe ajo shoqja...

-Jo, Nuk mundëm të jap dorën se...kam ndytë të kap me dorë. Kushedi çfarë ke kapur me dorë ti ...Hajde, ikim shpejt! - thoshte gruaja e re... dhe iknin, duke e lënë Torunin, duke bërëtitur...

- Ah, more xhajë, do të jenë lagur edhe paratë! - thoshte burri, duke ecur krah gruas ...

- Heu, or ti!, - thoshte Toruni i çuditur, - Asnjë nuk të ndihmon të shpëtosh ...Po, unë në kohën time; dmth, kur kam qenë i ri dhe në fuqi, kë

nuk kam ndihmuar dhe ja sot edhe ata që i kam ndihmuar, duke rrezikuar edhe vetën dhe ja si ta shpërblejnë ...edhe kur i thirr, duke qenë në rrezik, bëjnë sikur ...nuk të dëgjojnë, sikur nuk të kanë parë ...sikur ...Heu, or ti!, Heu, or ti! Ndërsa po i rrëshqisnin këmbët dhe po fundosej në ujë

Të fundosurit zhduku, sikur nuk kishte qenë kokën e tij dhe thirrjet çjerrëse. Uji rridhte si përherë, duke i marrë jetën Torunit dhe duke e çuar trupin e tij në fund të tij.

Thirrjet e Torunit për ndihmë tani i zëvendësuan thirrjet e njerëzve: "O ç'a zani, more ! Sapo është mbytur një njeri!" Zëri dhe thirrja thuhej gojë me gojë e dëgjohej vesh me vesh me një çudi, që po shtohej vazhdimisht -Kush ishte fatkeqi ? Pse ishte mbytur ? Aksidentalisht apo e kishin mbytur? Kishte qenë i ri a i vjetër? Apo fëmijë? Burrë apo grua? Do të ketë qenë ndonjë me depresion ...Të gjithë pyesnin me kureshtje ...ngrinin supet dhe shikonin njeri-tjetrin të çuditur

Shpejt lajmi mori dhenë ...U njoftua dhe policia, që bëri njoftimet përkatëse sipas rregullave, që kishte si dhe televizionin, i cili e shkroi mënjeherë me të kuqe si lajm të fundit: " Në kanal in e Sukës, që kalon midis Fushës së Zvezës, sapo është mbytur një njeri, që nuk dihet kush është, arsyet Po kërkohet për gjetjen e tij dhe sqarimin e rrethanave të ngjarjes ..." Kishte kaluar kohë dhe lajmi jepej në rrjedhën kohore, si ngjarje, kur kishte ndodhur.

Ndërkohë, aty nga dreka, mbi ujin e kanalit u duk të fluturonte shumë afër sipërfaqës së tij si një mizë madhështore, një helikopter, po pas disa fluturimeve, nuk u duk më, sepse nuk e pa asgjëkundi.

Në një vend kishin parë një gjë, që notonte mbi ujë, por kishte qenë një dërrasë e gjerë. Pas pak, te kanali erdhën polumbarët dhe nisën të kërkonin ...dhe pas shumë kërkimesh e gjetën... E gjetën dhe e varrosën duke mbetur vetëm historia, "... që në ujin e këtij kanali ishte mbytur një njeri. Zoti i ruajtë të tjerët se ura akoma nuk është ndërtuar ...!"



homazh

Ndahet nga jeta humanisti Luan Pustina, Basha: Edhe pse u cilësua i deklasuara nga diktatura, s'nguroi të merrte përsipër vepra të mira

# LAMTUMIRË LUAN PUSTINA

**Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka ndarë me miqtë e tij në "Facebook" lajmin e hidhur të ndarjes nga jeta të Luan Pustinës, shkencëtarit, humanistit dhe aktivistit të madh.**

**Kreu i PD-së, Lulzim Basha, në një mesazh ngushëllimi, shkruan se Luan Pustina përvijoi gjatë viteve të diktaturës komuniste, figurën e intelektualit të pa kompromis, i cili, sipas Bashës, nuk ngurroi të merrte përsipër punë të mira për komunitetin, pa pyetur për klasifikimin që pushteti i kishte bërë atij si një "i deklasuara".**

## POSTIMI I PLOTË:

Me hidhërim të madh mësova ndarjen nga jeta të Luan Pustinës, shkencëtarit, humanistit dhe aktivistit të madh të voluntariatit shqiptar. Pinjoll i njëjës prej familjeve të mëdha të Dibrës së Madhe, familjes patriotike Pustina, pjesëtarët e të cilës u vunë në krye të lëvizjeve antiosmane në fund të shekullit XIX, por edhe në lëvizjen legjendare kundër pushtuesve serbë në vitin 1913. Luan Pustina u lind në Tiranë, në gjirin e komunitetit dibran, që në vitet '20 të shekullit të shkuar dhanë një kontribut të madh për zhvillimin e

kryeqytetit.

Shkencëtarit Pustina përvijoi gjatë viteve të diktaturës komuniste, figurën e intelektualit të pakompromis, i cili nuk ngurroi të merrte përsipër punë të mira për komunitetin, pa pyetur për klasifikimin që pushteti i kishte bërë atij si një "i deklasuara".

Veprimtaria e një personaliteti si Luan Pustina u shtri në shumë fusha, jo vetëm si lektor në universitet, por edhe si pjesëmarrës në shumë konferenca shkencore ndërkombëtare si dhe në hartimin e mjaft punimeve për rritjen e investimeve të huaja në Shqipëri, punime që u bllokuan në 1997-n, sapo në pushtet erdhën pasardhësit e atyre që gjithë jetën e kishin cilësuar punën intelektuale të Pustinës si punë e dyshimtë e një të deklasuara. Ekspozent i komunitetit dibran të kryeqytetit dhe njëri nga ithtarët më të flaktë të ndërtimit të Rrugës së Arbrit, Luan Pustina ishte edhe një pionier i voluntariatit në Shqipëri, duke u angazhuar në shumë nisma bamirëse, të cilat ua lehtësuan sadopak ashpërsinë e tranzicionit mijëra nevojtarëve.

Me ndarjen nga jeta të Luan Pustinës, shoqëria humbi një zë intelektual, të pakompromis, për të cilin kemi aq shumë nevojë. Kontributi për të realizuar projektet që profesori la mbi tavolinë



si dhe nderimi i trashëgimisë së tij, përmes përpjekjeve të përditshme për drejtësi e për të luftuar varfërinë dhe prapambetjen janë mirënjohja më e mirë që të gjitha komunitetet e kryeqytetit mund të tregojnë për kujtimin e intelektualit Luan Pustina.

Në këtë moment dhimbje ju jam pranë bashkëshortes së tij znj. Gjyltere dhe dy vajzave Andias dhe Laurës.

**U prehtë në paqe!**

## BASHA, VIZITË NGUSHËLLIMI NË FAMILJEN E TË NDJERIT LUAN PUSTINA

Ditën e enjte, datë 01 gusht 2019, Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë z. Lulzim Basha, i shoqëruar nga Kryetari i Shoqatës "Bashkësia Dibrane" z. Bujar Kapexhiu, zhvilluan një vizitë, në shtëpinë e të njerit Luan Pustina, ku u takuan me familjarët e tij.

Ato u takuan dhe ngushëlluan bashkëshorten e të ndjerit, znj. Gjyltere dhe dy vajzat Andia dhe Laura Pustina, të shkencëtarit, humanistit dhe njeriut model të shoqërisë tonë, Luan Pustinës, i cili ka kontribuar me mjaft mendime të vjera, projekte studimore, ekonomiko-sociale mbi Rrugën e Arbrit etj.

Zoti Lulzim Basha, e quajti humbje të madhe ndarjen nga jeta të intelektualit Luan Pustina, i cili me punë, i ka lënë brezave të ardhshëm një trashëgimi të fuqishme, për të luftuar me intelekt varfërinë, prapambetjen, për të vendosur arsyetimin mbi padrejtësisë. Ai ishte shembulli model i një prindi të nderuar, e që me egon e tij krijoi një shoqëri të veçantë dhe u dallua për projektet të dobi të komunitetit dibran të Tiranës, në studime mbi voluntariatit shqiptar, në nisma bamirësie, pjesëmarrës në dhjetra konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në sesione shkencore, theksoi z. Basha.

Ndërsa kryetari i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", z. Bujar Kapexhiu vlerësoi shumë punën e pakursyer dhe të palodhur të Luan Pustinës, figurë që transmetonte vetëm mirësi dhe pozitivitet.

Nën gjurmët e tij, komuniteti dibran, njeh mjaft arritje në realizime aktivitetesh, konferencash dhe sesione shkencore mbi genocidin serb në trojet shqiptare, projekti ekonomiko-social mbi Rrugën e Arbrit etj.

Ndërsa znj. Gjyltere, vlerësoi kontributin e Luanit si bashkëshort e si prind model në edukimin e fëmijëve e brezave të ri. Ai u largua nga kjo botë, me mjaft projekte të përcaktuara.

Dy vajzat e z. Luan Pustina, Andia dhe Laura, të emocionuara, vlerësuan vizitën e z. Lulzim Basha dhe i përcollën atij respektin e veçantë që babai i tyre kishte për të.

Gjithashtu ato morën angazhim që të gjitha materialet studimore, problematikat me karakter ekonomik dhe social, të Luan Pustinës t'i botojnë në një vëllim shkencor i cili do të mbajë emrin e tij, e që do të promovohet në bashkëpunim me shoqatën "Bashkësia Dibrane" në një akademi solemne.



## Homazh për Agron Lalën

Para disa ditësh u largua nga kjo botë Agron Lala.

Ishte një mësues i talentur, njeri me vlera të rralla, një intelektual, një aktivist, një personalitet shumë dimensional. Agron Lala do mbetet shembulli i pashoq që i shërbeu arsimit të brezave me gjithë forcat dhe intelektin e tij. Ai i ka dhënë një zhvillim të rëndësishëm arsimit në zonën e Zerqanit dhe më gjërë në gjithë Dibër. Fati më ka bërë që të marr mësimet e hershme nga ana e tij duke qene një nga mësuesit e mi të talentuar. E kam patur jo vetëm mësues por njëkohësisht shok dhe mik. Nga thellësia e zemrës i shpreh ngushëllimet e sinqerta bashkëshortes, fëmijëve të tij, dhe të afërmve.

Agron Lala la gjurmë të pashlyeshme si një mësues i devotshëm, i përkushtuar me zell pas mësimdhënies, ku shpesh përmasat e Tij e kalonin rolin e një edukatori.

**Halil TEODORI**

**I paharruar qoftë kujtimi tij!**





Ferit Keta, i cili stërvitet nga vëllai i tij Ismaili, hapat e parë në karrierë si profesionist i ka hedhur rreth 3 vite më parë, ku më 19 shkurt të 2016-ës ka marrë edhe fitoren e tij të parë, në duelin e zhvilluar në pallatin e sportit "Asllan Rusi"



## Boks, uragani Ferit Keta shkatërron serbin që në raundin e tretë

Një kundërshtar që përveç boksit, njihet edhe si një luftëtar i dueleve në kafaz. Megjithatë, ndeshja u dominua në çdo aspekt nga boksieri bulqizak, i cili ishte dukshëm superior ndaj kundërshtarit serb. Ketës i mjaftuan vetëm tri raunde për ta shembur në tapet rivalin, pasi Mitiç e kishte të pamundur që t'u bënte ballë goditjeve të shpejta e të fuqishme të boksierit shqiptar.

Ky ishte triumfi i nëntë me KO për boksierin kuqezi në karrierë, ndërkohë që serbi Mitiç pësoi disfatën e tij të dhjetë, ndërsa numëron edhe 10 fitore. Pas fitores shpërtheu festa në ring ku binin në sy flamujt e shumë kuqezinj që kishin rrethuar boksierin shqiptar.

Ferit Keta, i cili stërvitet nga vëllai i tij Ismaili, hapat e parë në karrierë si profesionist i ka hedhur rreth 3 vite më parë, ku më 19 shkurt të 2016-ës ka marrë edhe fitoren e tij të parë, në duelin e zhvilluar në pallatin e sportit "Asllan Rusi", aty ku mposhti serbin Haris Calakoviç, për të vijuar më pas me vetëm triumfe në të gjitha sfidat e zhvilluara.

### BOKSIERI KAMPION FERIT KETA TRIUMFON NDAJ SERBIT MITIC ME CO

28 korrik në 2:05 PD · Sapo u mbyll. Ora ka kaluar 1 pas mesnate. Por nuk mund të ishim në gjumë pa ndjekur kampionin kuq e zi. Ferit Keta triumfon si zakonisht, tashmë duke mposhtur në raundin e tretë serbin Mitiç me KO. I saktë në goditje, me forcën e grushtit si të kromit të Bulqizës, boksieri kampion shenoi fitoren e 13 dhe kjo është e 10 me KO, natyrisht pa asnjë humbje. Urime këtij kampioni të pathyeshëm, që stërvitet nga një super kampion, si Jonny Ismail Keta me të cilin

*Ferit Keta vazhdon të shkëlqejë në boksion profesionist, duke regjistruar vetëm fitore. Në mesnatën e së shtunës duke u gdhirë e diela, 30-vjeçari shqiptar korri suksesin e tij të 13-të në karrierë duke shkatërruar serbin Slavoljub Mitiç, në duelin e zhvilluar në Maltë, për peshat "kruizer" më 28 korrik.*



ia doli edhe këtë mbrëmje në Maltë. Faleminderit vëllezërve Keta që i japin kaq shumë atdheut dhe flamurit të tyre...!

### Para një viti Ferit Keta, për herë të parë kampion bote ne kikboks

Një vit më parë, Ferit Keta u shpall për herë të parë kampion bote ne kikboks, pasi mundi turkun Fatih Karakus në Mynih. Më 8 shtator 2018, ai fitoi në eventin e Dibrës së Madhe në boks dhe kundërshtari shfrytëzoi mediat dhe rrjetet sociale, duke i kërkuar revansh dhe vuri në ring titullin që mbante si kampion bote. Ferit Keta, që stërvitet nga trajneri i mirënjohur Ismail Keta, fitoi bindshëm duke arritur që ta mposhtë rivalin e tij dhe të fitojë një titull Europe. Kjo ishte ndeshja e 19-të në kikboks për Ketën dhe të gjitha i ka fituar, ndërsa në boks ka 11 ndeshje dhe asnjë humbje.

Defrim METHASANI

